



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 142, datë 14.03.2024

“PËR CAKTIMIN E DITËS SË PREMTE, DATË 15.03.2024, DITË PUSHIMI”

Këshilli i Lartë Gjyqësor në perputhje me nenin 61 të Ligjit nr 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me nenin 89 të Ligjit 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si edhe të efekteve të krijuara nga Vendimi nr. 156, datë 13.03.2024 të KM, në përfaqësimet e Institucioneve Shtetërore në gjykime apo në organizimin dhe funksionet e shërbimeve të tyre që lidhen me kryerjen e aktivitetit të gjyqsorit;

VENDOSI

1. Caktimin e ditës së premte, datë 15.03.2024 ditë pushimi për Gjyqtarët, administratën gjyqësore dhe Administratën e Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Përfshihet nga zbatimi i pikës 1 të këtij Vendimi, gjyqtarët dhe administrata gjyqësore që kanë për shqyrtim gjykime me karakter të ngutshëm procedural të cilat shqyrtohen brenda 48 orëve.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, si dhe Shërbimet e Marrëdhënieve me Publikun të Gjykatave për zbatimin dhe njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR